



Pranuar / Dorezuar Prilježen / Predato Received / Delivered	30.08	2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org. Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No	Shënjë / Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKDMSTCK	5898	2023	116	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.Nr.932/2023**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave** në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare; Jeton Koca dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë; me Ardita Perçuku –Shyti, zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.932/2023, të datës 07.07.2023, të parashtruar nga ankuesi [redacted] nga Prizreni, kundër organit të punësimit: Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike-administrative ‘*Masë disiplinore*’, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1; nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1 nën paragrafin 1.2; të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 30.08.2023, njëzëri mori këtë:

**V E N D I M**

**I. Apropohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.932/2022, e datës 07.07.2023, e parashtruar nga ankuesi [redacted] ndërsa, **anulohet** Vendimi me numër KD.nr.029/2023, i datës 16.06.2023, i Komisionit Disiplinor, të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

**II. Obligohet** Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, ankuesit t’i bëjë kompensimin e pagesës së ndaluar sipas Vendimit KD.nr.029/2023, të datës 16.06.2023, të Komisionit Disiplinor në Shërbimin Korrektues të Kosovës, ndërsa, **obligohet** Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore, në Shërbimin Korrektues të Kosovës, të largoj nga dosja personale e nëpunësit civil si dhe regjistri përkatës masën disiplinore e anuluar si në pikën I.

**IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

**A r s y e t i m**

Nëpunësi civil, [redacted] (tutje vetëm ankuesi), më datë 07.07.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.nr.932/2023, kundër Vendimit me numër KD.Nr.029/2023, të datës 16.06.2023, të



Komisionit Disiplinor në Shërbimin Korrektues të Kosovës, për shkak të shkeljes së procedurave ligjore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikimit të gabuar të dispozitave materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme vetëm *Këshilli*), në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 11.07.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Shërbimin Korrektues të Kosovës, ndërsa, kjo e fundit, më datë 12.07.2023, ka përcjell përgjigjen në ankesë, së bashku me shkresat e lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendimin me numër protokolli 5675/2023 të datës 15.08.2023, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës edhe për 10 ditë pune.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën e datës 07.07.2023 me Nr.Prot:5092/2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër KD.nr.029/2023 të datës 16.06.2023 të Komisionit Disiplinor të SHKK-së; Komunikimet elektronike të datës 30.05.2023 ndërmjet nëpunësve në institucionin e SHKK-së; Certifikatën mjekësore për ankuesin të datës 13.06.2023; Shkresën zyrtare të datës 15.15.2023 nga Komisioni hetimor i SHKK-së për Zëvendësuesin e Zëvendës Drejtorit të Q.P në Prizren; Informatën me Nr.563 të datës 05.05.2023 nga ankuesi për zëvendësuesin e zëvendës Drejtorit të Q.P në Prizren; Ftesën për intervistë të datës 29.05.2023 nga Kryesuesi i Komisionit Disiplinor për ankuesin; Komunikimin elektronik të datës 04.05.2023 personave gjegjës në SHKK; Formën e intervistimit të datës 08.05.2023 nga stafi intervistues për RR.K; Informatën nga RR.K të datës 08.05.2023 për Drejtorinë e Burgut të Qarkut në Prizren së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Ftesën për intervistë përmes emailit zyrtar të datës 08.05.2023 nga H.S për ankuesin; Formën e intervistimit të datës 10.05.2023 nga stafi intervistues për ankuesin për faqet nr.1, nr.2, nr.3, nr.4, nr.5 dhe nr.6; Raportin përfundimtar të datës 15.05.2023 nga Komisioni Hetimor i Qendrës së Paraburgimit në Prizren; Urdhrin e datës 05.05.2023 për fillimin e hetimeve nga Zëvendësuesi i Zëvendës Drejtorit të Q.P në Prizren; Kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore të datës 18.05.2023 me Nr.KD/029 nga zëvendësuesi i zëvendës Drejtorit të Q.P në Prizren për Komisionin Disiplinor; Vërtetimin e datës 18.05.2017 nga Zyra e Burimeve Njerëzore në QPP për ankuesin; Certifikatën e ankuesit me numër Ref.nr.711/b të datës 24.06.2015; Certifikatën e ankuesit me Nr.02-285/II të datës 06.06.1991; Njoftimin mbi anulimin e konkursit për pozitën Drejtor në QP Prizren; Konkursin për pozitën e punës Drejtor i Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës[ nga MAPL; Certifikatat e ankuesit të bashkangjitura sikur në shkresat e lëndës; Formën për pushim vjetor të ankuesit e miratuar me datën 17.12.2021; Formën për pushim vjetor të ankuesit e miratuar me datën 18.06.2020; Kërkesën e datës 09.12.2019 nga ankuesi për bartjen e pushimit vjetor; Kërkesën e ankuesit të datës 19.06.2015 për orët e pushimit vjetor; Kërkesën e ankuesit të datës 14.11.2014 për orët e pushimit vjetor; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 11.07.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 12.07.2023 nga Shërbimi Korrektues i Kosovës së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Akt emërimit e ankuesit me numër AE.Nr.170/2023 të datës 05.05.2023 së bashku me përshkrimin e detyrave të punës të datës 03.01.2020; Procesverbalin e intervistës së ankuesit të datës 07.06.2023 për faqet nga 1-5 nga Komisioni Intervistues; Flet



kthesën e datës 20.06.2023 mbi pranimin e vendimit të Komisionit Disiplinor nga ana e ankuesit; Shkresën zyrtare sipas referencës me nr.04/2022 të datës 14.03.2022 lidhur me instruksionet e Drejtorit të QPP-së për stafin; Ftesën për intervistë të datës 14.06.2023 nga Komisioni Disiplinor për ankuesin; Procesverbalin e intervistës së H.I të datës 09.06.2023; Procesverbalin e Komisionit Hetimor të datës 18.05.2023 për rastin e Prizrenit 0575/23; Ftesën për intervistë të datës 08.06.2023 nga Kryesuesi i Komisionit Disiplinor për Zëvendësuesin e Zëvendës Drejtorit të QPP-së; Vendimin me Nr.08124/2 të datës 04.07/2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SHKK-së; Ankesën e ankuesit me Nr.858 të datës 26.06.2023 e parashtruar tek Komisioni për Ankesa; Korrespondencat e komunikimeve të datave 21.06.2023, 20.06.2023, 16.06.2023, 05.06.2023 ndërmjet ankuesit dhe nëpunësve gjegjës në SHKK; Formën për pushim vjetor të ankuesit e miratuar me datën 21.06.2023; Formën për pushim vjetor të ankuesit e miratuar me datën 08.05.2023 si dhe Vendimin me numër protokolli 5675/2023 të datës 15.08.2023 lidhur me vazhdimin e afatit të ankesës në Këshill; E-mailin zyrtar të datës 24.08.2023 nga Njësia e Burimeve Njerëzore të SHKK-së lidhur me dërgimin e dëshmisë për listën e pagave për ankuesin të muajit korrik të vitit 2023 si dhe shkresën lidhur me formularin e datës 07.07.2023 për të dhënat në listën e pagave për ankuesin.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se ankesa e ankuesit është e bazuar, *sepse:*

Nga analizimi i shkresave të lëndës rrjedhë se ankuesi është i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe se i njëjti sipas Kontratës së punës për kohë të pacaktuar, të datës 01.07.2022, është emëruar dhe ushtron pozitën e punës Udhëheqës i Zyrës së Pranimit, në Qendrën e Paraburgimit në Prizren.

Me tej nga provat materiale të kësaj çështje rezulton se Drejtori i QP në Prizren, në cilësi të Mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të ankuesit, me datë 18.05.2023, përmes shkresës më numër reference 0575/23, ka iniciuar procedurë disiplinore ndaj ankuesit, bazuar në propozimin e Komisionit Hetimor, dhënë në Raportin hetues, të datës 15.05.2023.

Komisioni Disiplinor me Vendimin me numër KD.Nr.029/2023, të datës 16.06.2023, ka shpallur përgjegjës ankuesin për shkelje të rëndë disiplinore sipas nenit 46 paragrafit 3, nën paragrafit 3.9 dhe 3.10; të Ligjit Nr.06-L -114 për Zyrtarët Publikë si dhe nenin 58 pika 3.4 dhe 3.12 të Ligjit Nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, duke i shqiptuar masën disiplinore “*ndalimi 20% e pagës për periudhë dy (2) muaj*”, me arsyetimin se ankuesi me veprimet e tij duke dalë pa autorizim jashtë institucionit ka nxjerrë dokumente zyrtare jashtë institucionit pa autorizim për qëllim që nuk dihet.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil pretendon që Komisioni Hetimor lidhur me rastin në fjalë nuk ka nxjerrë në pah dëshmi materiale lidhur me shkeljen disiplinore të ngarkuar ndaj tij, për kinse nxjerrjen e dokumentacionit zyrtar dhe se i njëjti komision me rekomandimet e dhëna nuk argumenton shkeljen e kryer nga ana e tij, përveç se thirren në incizimet e kamerave, i njëjti po ashtu pretendon se vet hetimi dhe raporti hetimor si dhe iniciimi i procedurës disiplinore ndaj tij janë të pa argumentuara me prova materiale dhe se vet akterët e Shërbimit Korrektues të Kosovës kanë pasqyruar diskriminimin e tij permanent për qëllime të caktuara, i njëjti kërkon që pas shqyrtimit të ankesës Këshilli ta hedh poshtë Vendimin e Komisionit Disiplinor me numër KD.Nr.029/2023 të datës 16.06.2023 si



vendim të pa bazuar, të pa argumentuar dhe kundërligjor.

Në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit iu referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë që rregullojnë disiplinën dhe procedurën disiplinore të nëpunësve civil, përkatësisht:

Nenit 45, me të cilin është përcaktuar se: *“Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. “ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;” 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit”.*

Nenit 46, me të cilin është përcaktuar se: *“... Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta. 3. Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mos përmbushja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës; 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i dehur në punë. 4. Shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar.*

Nenit 47 paragrafin 1, me të cilin në mënyrë taksative janë përcaktuar masat disiplinore: *“Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil”.*

Nenit 48, me të cilin është përcaktuar kompetenca lëndore për shqiptimin e masave disiplinore: *“3. Masat disiplinore të parashikuara në paragrafin 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji, janë në kompetencën e komisionit disiplinor. 4. Komisioni disiplinor fillon procedurën: 4.1. me kërkesë të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të nëpunësit civil; 4.2. me rekomandim të çdo organi tjetër publik ose njësie me kompetenca kontrolli administrativ, inspektimi financiar apo auditimi, ose të çdo zyrtari tjetër me detyra kontrolli hierarkik mbi nëpunësin civil, si dhe me kërkesën e qytetarit; 4.3. me nismën e çdo anëtarit të komisionit, bazuar në fakte konkrete të provueshme për kryerjen e një shkeljeje disiplinore”.*

Rrjedhimisht, në kuptim të dispozitave ligjore si më sipër, Kolegji ka analizuar provat materiale të çështjes, përkatësisht: Raportin e Komisionit Hetimor lidhur me hetimin e rastit të datës 04.05.2023 për nxjerrjen e dokumentacionit zyrtar nga institucioni pa autorizim nga Mbikëqyrësi i Lartë (ankuesi) në Qendrën e Paraburgimit në Prizren ku tek gjetjet dhe konkluzionet e këtij



raporti është konstatuar se, citoj: *“Mbikëqyrësi i lartë Shaban Kamberaj pa asnjë autorizim dhe lajmëruar askënd ka dalë nga institucioni të 3-4 herë në intervale të ndryshme kohore ku ka nxjerr dokumentacion zyrtar institucional, duke i vendosur në makinën e tij private”*; Vendimin KD.nr.029/2023 të datës 16.06.2023 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës sipas te vili është konstatuar se citoj: *“Në QP-Prizren me datë 04.05.2023 z.Shaban Kamberaj Mbikëqyrës i lartë kishte nxjerrë dokumentacion zyrtar nga QP-Prizren, pa autorizim dhe duke i futur në veturën e tij private të cilën e kishte parkuar shumë afër portës kryesore të Qendrës së Paraburgimit në Prizren”, ku sipas vendimit në fjalë ankuesi me veprimet e tij duke dalë pa autorizim jashtë institucionit dhe duke nxjerrë dokumente zyrtare jashtë institucionit pa autorizim për qëllim që nuk dihet, ka bërë shkelje të rëndë disiplinore të paraparë me dispozitat ligjore të nenit 46 paragrafit 3, nën paragrafin 3.9 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.*

Po ashtu, Kolegji ka analizuar edhe deklaratën e ankuesit dhënë në seancën dëgjimore pranë Komisionit Disiplinor të datës 07.06.2023, ku i njëjti kishte deklaruar, citoj: *“Pas vendimit që kam marrë me liru detyrën nga Zëvendësuesi i zv.Drejtorit në QP-Prizrenit, në mes meje dhe Z. Ilazi, ...ai me tha ta liroj zyrën dhe te kaloj në zyrën ekzekutive, me veti kam marre kompjuterin personal, 2 sirtar te mi personal, dhe kam filluar ti sistemoj, pas dy ditëve me vjen emaili zyrtar nga Drejtoria Qendrore që me nga Udhëheqësi i Zyrës së Pranimit të kaloj në pozitë të mbikëqyrësit të Lartë. Të nesërmen zv.drejtori z. Iliaz në mëngjes me vjen në zyrë dhe me autorizon që kompjuterin dhe pajisjet e mija të liroj atë zyrë, kam filluar të largoj dokumentacionin tim personal, libra të evidencave, tmia që kam mbajtur, dokumentacionin e trajnimeve të llojllojshme, diplomat e mija ... gjithë ky dokumentacion është vendosur në qese të tejdukshme, dhe gjate daljes te porta i qes ne tavolinën e bastisjes e njoftoj zyrtarin që është dokumentacion personal shiqoje. ...më kërkesë të udhëheqësit të sigurimit kam kthyer dokumentet e fundit, ... dokumentacioni i kthyer ka qenë personal...”* :

Andaj, referuar fakteve si më sipër, Kolegji vlerëson së Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës nuk ka vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, lidhur me ketë çështje juridiko administrative, dhe në ketë mënyrë gabimisht është zbatuar e drejta materiale, për shkak se Komisioni Disiplinor kishte dështuar në vërtetimin e fakteve bazë përkatësisht Komisioni Disiplinor nuk kishte marrë për bazë se arsyeja e lëvizjes së ankuesit dhe bartja e dokumentacionit kishte ndodhur si rezultat i Vendimit Nr.544, të datës 03.05.2023, të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit, sipas të cilit vendim ankuesi është ri sistemuar nga pozita e punës ‘‘Udhëheqës i Zyrës së Pranimit’’ në Qendrën e Paraburgimit në Prizren në pozitën e punës ‘‘Mbikëqyrës i lartë Grada III’’ në Qendrën e Paraburgimit në Prizren , ku dhe si rrjedhojë e zbatimit të këtij vendimi ankuesi është dashur që të lëviz nga zyra e tij duke nënkuptuar edhe lëvizjen e dokumentacionit të tij personal. Për më tepër Komisioni hetimor në raportin hetimor të datës 04.05.2023, e mbi këtë fakt edhe Komisioni Disiplinor në vendimin e kundërshtuar më ankesë, kanë konstatuar se ankuesi ka nxjerr dokumentacion zyrtar jashtë institucionit pa autorizim dhe për qëllime që nuk dihen, veprime këto që sipas tyre përbëjnë shkelje të nenit 46 paragrafit 3 pika 3.9 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *“ shkelje e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për te dhënat e klasifikuara si të tilla”*, Rrjedhimisht, në vlerësimin e Kolegjit një konstatim i tillë nuk ka mbështetje ligjore dhe si i tillë nuk është i argumentuar me prova relevante, për arsye se Komisioni Hetimor dhe Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues, nuk kanë arritur të vërtetojnë së çfarë dokumentesh janë nxjerr nga ankuesi, rrjedhimisht nuk është vërtetuar lloji dhe përmbajtja e dokumenteve të nxjerra nga ankuesi dhe se me rastin e kthimit të



dokumentacionit bazuar në provat e lëndës nuk është mbajtur asnjë lloj regjistrimi lidhur me evidentimin e dokumentacionit të kthyer, përkatësisht nga zëvendës Drejtor i QP në Prizren dhe Udhëheqësi për siguri përkundër faktit që ishte kërkuar kthimi i dokumentacionit nga ankuesi, nuk ishte bërë regjistrimi i dokumentacionit të kthyer përshtirë identifikimin e llojit ( zyrtare apo personale), përmbajtjes dhe sasisë së dokumenteve, nga vërtetimi i të cilave fakteve do të konstatohej në mënyrë të drejtë dhe të plotë përgjegjësia disiplinore e ankuesit, kështu që, pretendimet ankimore të ankuesit në këtë drejtim janë të bazuara.


Nisur nga konstatimet si më lartë, Kolegji vlerëson se Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës me rastin e shpalljes përgjegjës të ankuesit për shkelje të rëndë disiplinore sipas nenit 46, paragrafit 3, nën paragrafit 3.9 dhe 3.10; të Ligjit Nr.06-L -114 për Zyrtarët Publikë, nuk ka arritur të ofroj dëshmi bindëse së janë përmbushur në mënyrë kumulative elementet e përgjegjësive disiplinore siç parashihet me nenin 45 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *“Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. “ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;” 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit”*. Dhe po ashtu në vlerësimin e Kolegjit, Komisioni Disiplinor me rastin e shqiptimit të masës disiplinore “ndalimi 20% e pagës për periudhë dy (2) muaj”, nuk ka marrë për bazë edhe parimin e individualizimit siç përcaktohet me nenin 50 paragrafin 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Përmbledhur si më sipër, Kolegji në vështrim të dispozitave të nenit 52, paragrafit 1, nën paragrafit 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, konstaton se një akt administrativ i nxjerrë me shkelje procedurale dhe në kundërshtim me dispozitat materiale është akt i paligjshëm, andaj, në mbështetje të nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrtës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.932/2023.

Ardita Perçuku-Shyti  
  
Procesmbajtëse

Ardita Haxhiukaj-Demi  
  
Kryetare e Kolegjit



### Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit.
- Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

